

## RREGULLA PËR PËRDORIMIN E SIGURTË TË KARTËS SË DEBITIT/KREDITIT

### UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

- » Në momentin e marrjes në dorëzim të Kartës së Debitit/Kreditit, firmosni menjëherë në pjesën e pasme të tyre, në përputhje me Nenin 2 të kontratës.
- » Mos e mbani PIN-in në të njëjtin vend ku mbani edhe kartën.
- » Asnjëherë mos e shkuani PIN-in në kartë.
- » Ju mund të vendosni PIN që dëshironi pranë çdo ATM-je të Bankës sonë menjëherë pasi karta të bëhet aktive.
- » Asnjëherë mos lejoni ndonjë person tjetër të vendosë PIN-in në ATM për ju.
- » Gjithmonë vendosni PIN-in duke u siguruar që askush të mos e shohë atë.
- » Në rast se zarfi në të cilin ju dorëzohet PIN-i është i hapur, mos e pranoni atë por kërkoni printim të ri të PIN-it.

### UDHËZIME TË VEÇANTA

- » Nëse humbisni Kartën ose ju vidhet nga dikush, njoftoni menjëherë Bankën ose telefononi në numrin e kontaktit që paraqitet në reklamat e rrjetit të ATM-ve dhe në faqen e internetit të Bankës! Për të qënë më të sigurt, regjistroni që tani në telefonin tuaj numrin e kontaktit që gjendet i publikuar pas kartës suaj.
- » Kontrolloni periodikisht dhe me kujdes faturën e kartës së Kreditit dhe llogarinë/të e kartës së Debitit. Kontaktoni menjëherë Bankën nëse shihni ndonjë veprim të panjohur/dyshimtë.
- » Instaloni antivirus në kompjuterin personal ku përdorni kartën.
- » Kur përdorni internetin për blerje (on line) duhet të tregoni kujdes nga faqe interneti të dyshimta dhe false. Kur blerja me kartë realizohet nga një faqe interneti e sigurtë, adresa e faqes që përmban informacionin e kërkuar të kartës së debitit/kreditit duhet të ndryshojë nga "http" në "https". Ky fakt verifikon që faqja e internetit përmban çertifikatë të verifikueshme sigurie (SSL). Çdo herë që do jeni duke kryer blerje on line duhet të verifikoni këtë çertifikatë duke klikuar sipër ikonës në formë dryni.
- » Nëse kryeni pagesë për blerje në internet, pas konfirmimit të veprimit nga faqja e internetit fondet në llogarinë e kartës do të rezervohen automatikisht (zvogëlohet balanca e vlefshme në llogari/ limiti i kartës). Për të kontrolluar këtë balance, si edhe lëvizjet në llogari mund të përdorni E-banking 24 orë çdo ditë të javës. Nëse ndodh e kundërta, kur fondet nuk rezervohen, njoftoni menjëherë bankën për të verifikuar dhe shmangur çdo mundësi rreziku për humbje / vjedhje informacioni.
- » Pasi të keni kryer blerjen sigurohuni që të keni dalë (log out) nga faqja e internetit. Nëse faqja e internetit nuk ka mundësi për dalje (log out) mbylleni browser dhe bëni pastrimin e historikut të internetit dhe "cookies".
- » Mos e jepni kartën tek të tjerët për të kryer pagesë për ju. Mos ju përgjigjini apo dërgoni me e-mail apo celular të dhënat e kartës si, numër karte, datë skadence, CVV2 (kodi tre shifror prapa kartës) apo PIN. Banka asnjëherë nuk kontakton kartëmbajtësin për të kërkuar këto informacione.

### SUGJERIME/KËSHILLA

- » Evitoni kryerjen e blerjeve "online" nga celulari.
- » Evitoni përdorimin e kartës në rrjetet sociale si facebook, twitter, instagram etj.
- » Mos përdorni kartën në qendra interneti.
- » Mos lejoni që miqtë apo familjarët të përdorin kartën tuaj.

**Shënim:** Në rast se mbajtësi i kartës nuk i përmbahet këtyre këshillave të sigurisë, ai mban përgjegjësi të plotë për humbjet që mund të shkaktohen nga përdorimi i i kartës deri në momentin kur ai njofton bankën për bllokimin/mbylljen e saj.